



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E BUJQËSISË, USHQIMIT DHE MBROJTJES
SË KONSUMATORIT
AUTORITETI KOMBËTAR I USHQIMIT

Nr. 224 Prot

Tiranë më 26/11 2010

URDHER

Për

„Krijimin e një procedure mbi informacionin që duhet të përmbajë etiketa“

Bazuar në ligjit 9863, datë 28.01.2008 „Për Ushqimin“ dhe të VKM 1081 datë 21.10.2009 „Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit“ dhe duke patur parasysh problematikën që haset me etiketat e reja që paraqiten pranë Autoritetit Kombëtar të Ushqimit për miratim,

Urdhëroj:

1. Që në zbatim të ligjit 9863, etiketa që do të miratohet duhet detyrimisht të përmbajë këto elementë:
 - a) Emrin e produktit;
 - b) Listën e përbërësve;
 - c) Sasinë e përbërësve të vecantë ose të kategorive të përbërësve;
 - d) Sasinë neto, në rastin e ushqimeve të paraambalazuara;
 - e) Datën e jetëgjatësisë minimale ose, në rastin e ushqimeve që nga pikëpamja mikrobiologjike paraqesin rrezik, shënohet „të përdoret deri në...“;
 - f) Çdo kusht të vecantë të ruajtjes dhe/ose përdorimit;
 - g) Emrin apo emërtimin e biznesit dhe adresën e prodhuesit, ambalazhuesit dhe/ose të tregtarit;
 - h) Vendin e origjinës;
 - i) Udhëzimet e përdorimit, kur ushqimi nuk mund të përdoret pa të;
 - j) Gradën alkoolike për vëllim për pijet që përmbajnë më shumë se 1,2 për qind të vëllimit alkool;
 - k) Përmbajtjen ose përmbajtjen e OMGJ-ve, si dhe OMGJ-të që përmban.
2. Ngarkohet Drejtorja e Vleresimit dhe Komunikimit të Riskut dhe Drejtorja e Shërbimeve Mbeshtetese për njoftimin e Drejtorive Rajonale për zbatimin e këtij urdhri.
3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM



GENC JUKA